



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KRYETAR

Nr. 8996 Prot

Shkodër, më 27.05 .2019

URDHËR

Nr. 462 Datë 27/05 /2019

**PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË  
KONTRATAVE TË TREGUT "RUS"**

Mbështetur në nenet 8 dhe 28 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit me nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, ligji nr.8224, datë 15.05.1997 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Policisë së Bashkisë dhe të Komunës, i ndryshuar, ligj nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Ngritjen e grupit të punës për monitorimin në vazhdimësi të zbatimit të kontratave të lidhura, për shfrytëzimin e hapësirave publike, për ushtrim aktiviteti Ambulant, në Tregun Rus.
2. Grupi i punës përbëhet nga:
  - Drejtoria e të Ardhurave
  - Policia Bashkiake
  - Inspektori i Rajonit ✓
3. Ngarkohen inspektorët e Drejtorisë së të Ardhurave për monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të kontratave me tregtarët ambulant që ushtrojnë aktivitetin e tyre në modulet e ofruara për tregtim nga Bashkia Shkodër në tregun "Rus".
4. Inspektorët e të ardhurave do të monitorojnë dhe raportojnë tek eprori për:
  - Respektimin e kontratave të lidhura mes Bashkisë Shkodër dhe tregtarëve ambulant sipas planvendosjes bashkëlidhur kontratës;
  - Kontrollin e të gjitha moduleve për tregtim për rastet e tregtarëve "ambulant" të cilët përdorin modulën/modulet në pronësi të Bashkisë pa pasur një kontratë me Bashkinë Shkodër.
  - Kontrollin nëse tregtarët ambulant të cilët kanë lidhur kontratë me Bashkinë Shkodër e kanë tjetërsuar modulën/modulet e marra me kontratë në favor të të tretëve.

5. Ngarkohen inspektorët e Policisë Bashkiake për:
- Monitorimin dhe administrimin e hapësirës publike nga ana e subjektit që e shfrytëzon atë;
  - Monitoron rrespektimin e detyrimeve për t'u përmbushur nga ana e subjektit lidhur me pastërtinë në treg, shfrytëzimin e rregullt dhe pa tjetërsim të vendit të përcaktuar për tregëtim, rendin dhe qetësinë publike, dhe të tjera aspekte duke lehtësuar funksionimin e rregullt të tregut ditor.
  - Ndalimin e futjes në treg të mjeteve motorrike (motorr, veturë, furgon etj) të cilat çënojnë hapësirat për tregëtim.
6. Inspektori i Rajonit ka për detyrë monitorimin dhe koordinimin e punës për mirëfunksionimin e tregut "Rus".
- Ai ngarkohet për:
- Koordinimin dhe monitorimin e punës së punëtorëve të shërbimit dhe rojeve në treg;
  - Mirëfunksionimin e të gjithë infrastrukturës dhe logjistikës së tregut "Rus";
  - Ruajtjes dhe mbajtjes pastër brenda standardeve të ambjenteve brenda dhe jashtë tregut "Rus";
  - Monitoron respektimin e kushteve të tregtimit pa cënuar elementet konstruktive të parashikuara në projektin e zbatimit të tregut "Rus".
7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria e të Ardhurave, Policia Bashkiake dhe Inspektori i Rajonit.
8. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Voltana Ademi**

